

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit B. B., nga Komuna e Malishevës, të cilin e përfaqëson av. Xh. K. nga Prishtina, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës(KEK)-Divizioni në Prishtinë, të cilën e përfaqëson O. K., me autorizim, për shkak të kompensimit të dëmit, përkitazi me revizionin e së paditurës paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.552/2013 datë 27.05.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 19. 10. 2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Refuzohet si i pathemeltë revizioni i së paditurës paraqitur kundër pjesës së I dhe II të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.552/2013 dt.27.05.2016 që kanë të bëjnë me kompensimin e dëmit jo material dhe material.

A r s y e t i m i

Me pjesën e I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës të Gjykatës Komunale në Malishevë C.nr.78/2011 dt.18.12.2012, pjesërishtë aprovohet kërkesëpadia e paditësit, detyrohet e paditura që paditësit të ia kompensojë dëmin jo material dhe material, për shkak të zjarrit që ka ndodhur në shtëpinë e tije me dt.4.11.2008 dhe ate: për dëmin jo material, në emër të dhimbjeve fizike shumë prej 1200€, për frikë 1000€, për shëmtim trupor 800€, ndërsa, për dëmin material në shtëpinë e tijë, pastrimin e ndotjes, meremetimit në shumë prej 2645,21€, për dëmin e shkaktuar në pajisjet shtëpiake 255€si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 726€, krejt në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Me pjesën e II, kërkesëpadinë e paditësit, përtej shumave të gjykuara e ka refuzuar si të pabazuar.

Me Pjesën e I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.552/13 dt.27.05.2016, pjesërishtë aprovohet ankesa e së paditurës, ndryshohet pjesa I, pika 1.A) e dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë, ashtu që detyrohet e paditura që paditësit t'i paguajë për dëmin jo material, për dhimje fizike shumë prej 800€, për frikë 600€ dhe për shëmtim trupor 500€, për tepricën e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar. Me pjesën e II, vërtetohet pjesa I pika B) e dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë që ka të bëjë me kompensimin e dëmit material të shkaktuar nga zjarri në shtëpinë e paditësit dhe pajisjet

shtëpiake. Me pjesën e III, pjesët tjera të aktgjykimit të shkallës së parë që kanë të bëjnë me refuzimin e kërkesëpadisë përtej shumave të kërkuara, mbeten të pashqyrtuara.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor, ka paraqitur revizion e paditura për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet revizioni, aktgjykimet e instancave më të ulta të ndryshohen dhe të refuzohet kërkesëpadia.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimit të goditur në pajtim me nenin 215 të LPK, gjeti se:

Revizioni i së paditurës është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës(raporti i policisë, ekspertizat mjekësore, ekspertiza e ekspertit të elektroteknikës, ekspertiza e ekspertit të ndërtimtarisë etj) rezulton se me datë 4.11.2008, rreth orës 01,35 min, në shtëpinë e paditësit , që gjendet në fshatin ... , Komuna e Malishevës, është shkaktuar zjarri dhe si pasojë i janë djegur orendit shtëpiakë, televizori, radio, dera, dritaret, dyshemeja, koridori, dhoma, tymosja e shtëpisë, makina elektronike e shtypit etj. Zjarri i shkaktuar në shtëpinë e paditësit është rezultat i defektit në trafostacionin 10/04kv/kv të lagjes “...” në ... të Malishevës, nga se, sikundër ka gjetur eksperti elektroteknikës, në ormanin e trafostacionit të sipërcekur (foto 5,6 dhe 7 si pjesë përbërse të ekspertizës) shifet lidhja e përçuesve të zeros në shina të bakrit ku dyshohet se ka ardhur deri te këputja e përçuesit zero dhe se në sistemin elektro energjetike të tensionit 04kv sistemi trefazor pas këputjes së zeros në këto instalime vije deri te paraqitja e tensionit ndër fazor në sistemin njëfazor, prezenca e sistemit të tre fazave pa zero shkakton djegëjen e pajisjeve elektrike me fuqi të vogla sepse vije deri te paraqitja e tensionit ndër fazor në sistemin njëfazor. Nga ky defekt, kanë pësuar edhe qytetarë tjerë dhe shkolla e lagjes në fsh...Përveç dëmit material të shkaktuar nga zjarri në shtëpinë e paditësit, në lartësinë e sipër cekur, paditësi ka pësuar edhe lëndim të lehtë trupor. Është mjekuar në QKMF-Malishevë dhe QKUK-Qendra emergjente në Prishtinë. Kishte marrë plagë shqyese në regionin e parakrahut të djathtë, e përpunuar në qendrën emergjente, dhimbje fizike të intensitetit të rënd 24-orë,të mesëm 2 javë deri në pjekjen e penjve nga parakrahu i djathtë dhe të ulët 2 javë, me shëmtim të shkallës së ulët për shkak të vrazës së mbetur në regionin e mesëm të parakrahut të djathtë në gjatësi prej 4 cm, frikë primare në formë të frikës nga vdekja dhe kërcënimit direkt të integritetit fizik që ka zgjatur 2 min, frikë sekondare të intensitetit të lartë 24

orë, të ulët 1 muaj, e shoqëruar me gjendje të stresit akut pasiguri të herëpashershme dhe shqetësime të gjumit.

Në bazë të kësaj gjendje faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë, ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka vendosur si në pjesën I, pika A, B dhe II të dispozitivit të aktgjykimit të sajë.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore, e ka miratuar pjesërisht ankesën e së paditurës, ka ndryshuar pjesën e I, pika A të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë që ka të bëjë me kompensimin e dëmit jo material dhe ka vendosur si në pjesën e I,II dhe III të dispozitivit të aktgjykimit të sajë ,të sipërtheksuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata e shkallës së dytë ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat e së drejtës materiale, kur ka miratuar pjesërisht ankesën e së paditurës dhe ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë në kuptimin e mësipërme, ndaj, aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje të karakterit thelbësor të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat kjo Gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare.

Për sa i përket shumave të gjykuara nga Gjykata e shkallës së dytë (pjesa e ndryshuar)përkitazi me llojet e sipër përmendura të dëmit jo material, drejtë janë aplikuar dispozitat e nenit 173,nenit 174,nenit 190,nenit 200 të LMD-ës e lidhur me nenin 323 të LPK-ës, duke patur parasysh konstatimet dhe mendimet e ekspertëve mjekësor, të Elektroteknikës, të ndërtimtarisë ,etj, lëndimet e pësuar, natyrën, peshën, intensitetin e dhimbjeve,frikës dhe shkallën e shëmtimit trupor të paditësit. Vlerësimi i shpërblimit për dëmin jo material(si një satisfakcion që nuk ka qëllim lukrativ-fitimprurës),përfaqëson zbatimin e së drejtës materiale. Gjatë caktimit të lartësisë së shpërblimit për format e caktuara të dëmit jo material, edhe të frikës si lloj i mëvetësishëm i dëmit jo material, gjykata sipas nenit 200 të LMD-së, duhet të kujdeset për rëndësinë e së mirës së dëmtuar dhe qëllimit të cilit i shërben ai shpërblim, por, edhe për çështjen që të mos favorizojnë synimet të cilat nuk janë në përputhje me natyrën e shpërblimit të tillë të dëmit jo material dhe qëllimin shoqëror. Prandaj, duke patur parasysh këto kritere të parapara me dispozitën e lartëcekur, shumat e caktuara nga gjykata e shkallës së dytë, përkitazi me llojet e sipër cekura të dëmit jo material dhe ato material(nga gjykata e shkallës së parë),sipas vlerësimit të kësaj Gjykate janë reale, në përputhje me kriteret e parapara ligjore dhe në harmoni me praktikën gjyqësore. Nga këtu, thëniet e revizionit lidhur me lartësinë e shumave të gjykuara,

kjo Gjykatë i vlerësojë si të pathemelta. Gjykatat e instancës më të ulët aktgjykimin e mbështesin në mendimin dhe konstatimin e ekspertëve mjekësor, të elektroteknikës, të ndërtimtarisë si dhe provat tjera të administruara nga të cilat kanë vërtetuar dëmin material dhe jo material, llojet e tyre, shkaktarin e dëmit, pasojat dhe kanë gjetur se është përgjegjësi objektive e së paditurës, që rrjedh nga veprimtaria e rrezikshme e sajë.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar se Gjykatat e instancës më të ulët drejtë e kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë konkluduar se e paditura i ka shkaktuar dëm paditësit nga se me dispozitën e nenit 154.2 të LMD, parashihet se kush tjetrit i shkakton dëm, është i detyruar që të ia shpërblejë atë, po qese nuk provon se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij, kurse sipas nenit 190 të Ligjit të cekur, rrjedhë se gjykata cakton shpërblimin e dëmit në shumën që është e nevojshme për t'u rivendosë gjendja materiale e të dëmtuarit e cila ka qenë para shkakimit të dëmit. Po ashtu, edhe me nenin 173 të Ligjit të sipërcituar, rezulton se dëmi i krijuar në lidhje me sendin e rrezikshëm përkatësishtë me veprimtarinë e rrezikshme, konsiderohet se buron nga ai send, përkatësishtë veprimtari, përveç nëse provohet se ato nuk ishin shkaktar të dëmit. Ndërsa, për dëmin nga sendi i rrezikshëm përgjigjet(sipas parimit –bazës së përgjegjësisë objektive)poseduesi i tijë, kurse, për dëmin nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet personi që mirët me të(neni 174 i LMD-së)sis është edhe rasti konkret juridiko-civil.

Nga sa u theksua më lartë, e në mbështetje të dispozitës së nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr.249/2016 datë 19. 10. 2016

Kryetari kolegjit

Mr.Sc.Muhamet Rexha